



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE**  
**KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

13.02.2021

Qeverisja e shoqërive tregtare dhe zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe të biznesit

**TEZA 2**

**ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)**

**1. Procesi i zgjidhjes së konfliktit të interesit në auditim inicohet nga:**

- a. Çdo auditues ligjorë;
- b. Audituesi ligjorë që gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë me parimet themelore etike, gjatë ushtrimit të profesionit ka konstatuar se mund të ekzistojë një konflikt që lidhet me zbatimin e këtyre parimeve;
- c. a dhe b;
- d. Asnjëra
- e. Klienti
- f. Autoriteti rregullator
- g. Organizata profesionale
- h. f dhe g

**Përgjigje e saktë është alternativa B**

**2. Sipas Kodit të etikës për audituesit ligjor, në masat mbrojtëse të mjedisit të punës, të cilat mund të eliminojnë ose zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të ulët të pranueshëm, nuk përfshihet:**

- a. Diskutimi i çështjeve etike me personat që janë përgjegjës për qeverisjen e klientit;
- b. përfshirjen e një firme tjetër për të kryer apo përsëritur disa pjesë të angazhimit;
- c. caktimi i një anëtarit të nivelit të lartë të drejtimit me përgjegjësinë për të mbikëqyrur funksionimin e duhur të sistemit të kontrollit të cilësisë të firmës;
- d. rotacioni i arsyeshëm i personelit kryesor drejtues të grupit të dhënies së
- e. sigurisë.
- f. Të gjitha alternativat më sipër

- g. Asnjë nga alternativat a,b,c,d dhe e
- h. a,b dhe c

**Përgjigje e saktë është alternativa G**

**3. Kodi i Etikës, për audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese miratohet nga:**

- a. Parlamenti;
- b. Vendimi i Këshillit të Ministrave;
- c. Ministria e Financave;
- d. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese që janë aktivë dhe pasive në lidhje me ushtrimin e profesionit;
- e. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese që janë aktive në lidhje me ushtrimin e profesionit;
- f. Organizata profesionale e audituesve ligjorë;
- g. Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale;
- h. Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

**Përgjigje e saktë është alternativa H**

**4. Në përdorimin e përditshëm etika mund të identifikohet me parimet që drejtojnë sjelljet e një individi ose të një grupi të fokusuara në dy drejtë:**

- a. Etikë biznesi dhe personale;
- b. Etikë profesionale dhe personale;
- c. Etikë institucionale dhe biznesi;
- d. Etikë dhe moral;
- e. Kod etike dhe etikë normative;
- f. Etikë personale dhe morale;
- g. Etikë menaxheriale dhe morale;
- h. Asnjëra nga alternativat.

**Përgjigje e saktë është alternativa B**

**5. Koncepti i cili qëndron në themel të pretendimeve morale dhe etike që lidhen me organizatat e biznesit njihet si koncepti i së:**

- a. Drejtës;
- b. Dobishmërisë;
- c. Paanshmërisë;
- d. Normativ;
- e. E drejtë menaxheriale;
- f. E drejtë normative;
- g. E drejta e pronësisë;

- h. Asnjë nga alternativat e mësipërme.

**Përgjigje e saktë është alternativa A**

**6. Parimet nëpërmjet të cilave vlerësohen politikat, institucionet dhe sjelljet në raport me përfitimet neto sociale që ato prodhojnë, kanë të bëjnë me *parimet*:**

- a. E të drejtave;
- b. e drejtësisë;
- c. e dobisë/utilitare;
- d. e të drejtave dhe e drejtësisë;
- e. e të drejtave dhe e dobisë;
- f. e drejtësisë dhe e dobisë;
- g. asnjëra;
- h. të gjitha.

**Përgjigje e saktë është alternativa C**

**7. Tek dilemat etike, pyetja: vendimi apo plani i veprimit a perceptohet që do të jetë i sinqertë në të gjithë rrethanat? ... i përket *testit*:**

- a. të përfshirjes;
- b. të përkatësisë së informacionit;
- c. të pasojave që rrjedhin;
- d. universal;
- e. të lehtësimit të ditës;
- f. të vlerave të qëndrueshme;
- g. të transparencës;
- h. të gjitha.

**Përgjigje e saktë është alternativa G**

**8. Sipas kodit të etikës së IFAC, profesionistët kontabël për të zgjidhur një çështje etike duhet të konsiderojnë:**

- a. Faktet;
- b. Çështjet etike të përfshira
- c. Parimet themelore të lidhura
- d. Procedurat e brendshme
- e. Veprimet alternative, duke marrë parasysh pasojnë e secilës prej tyre
- f. Të gjitha të mësipërmet
- g. Asnjë nga të mësipërmet
- h. a, b dhe e

**Përgjigje e saktë është alternativa F**

**9. Një shoqëri mund të influencojë punëmarrësit për çështjet etike nëpërmjet**

- a. Rekrutimit dhe procedurave dhe politikave përzgjedhëse
- b. Prezantimit të punës dhe trajnimit
- c. Objektivave dhe skemave të shpërblimit
- d. Kodit të etikës
- e. Të gjitha të mësipërmet
- f. a, b dhe d
- g. asnjë nga të mësipërmet
- h. a dhe d

Përgjigje e saktë është alternativa E

**10. Nuk është/janë avantazh i kodit të etikës të bazuar në parime:**

- a. Kodi i etikës i bazuar në parime parandalon interpretimet e ngushta
- b. Kodi i etikës i bazuar në parime mund të përshtatet shpejt në një ambient që ndryshon
- c. Shembujt ilustrative që jep kodi i etikës i bazuar në parime mund të zbatohen në të gjitha situatat e ngjashme
- d. Kodi i etikës i bazuar në parime përshkruan standardet minimale të pritshme të sjelljes
- e. Të gjitha të mësipërmet
- f. Asnjë nga të mësipërmet
- g. a dhe b
- h. a dhe c

Përgjigje e saktë është alternativa C

## **PYETJE ME SHTJELLIM (4 pikë secila pyetje)**

1. A përfaqësojnë tarifat e kushtëzuara të auditimit një kërcënim të përkrahjes (favorizimit). Argumentoni përgjigjen tuaj.

**Përgjigje:**

Tarifat e kushtëzuara janë tarifa të llogaritura në një bazë të paracaktuar që lidhet me rezultatin e shërbimit të kryer nga një shoqëri. (0.5 pikë)

Kërcënimet e favorizimit (përkrahjes) ndodhin kur një auditues ligjor favorizon një qëndrim apo një opinion deri në atë pikë, sa që kompromentohet objektiviteti i mëvonshëm. (0.5 pikë)

Nëse audituesi do të paguhet sipas një tarife të kushtëzuar, interesi i audituesit do të lidhet shumë ngushtë me atë të klientit. Të dy palët do të duan që të ndodhë e njëjta gjë (gjëja për të cilën është kushtëzuar tarifa) dhe është rreziku se audituesi do të veprojë në interes të klientit për tu siguruar që kjo të ndodhë. Pra audituesi do të humbasë objektivitetin dhe do të jemi në rastin e një kërcënimi favorizimi (përkrahje). (3 pikë)

2. Shpjegoni përse është kaq e rëndësishme pavarësia e audituesit të jashtëm.

**Përgjigje:**

**Pavarësia e audituesit është e rëndësishme pasi:**

- aksionarët dhe palët e tjera të interesit kanë nevojë për një opinion të besueshëm të kujdestarisë së drejtuesve, për të qenë në gjendje të marrin vendime për kompaninë. Siguria e ofruar nga audituesit e pavarur është një kontroll kryesor i cilësisë mbi besueshmërinë. (1 pikë)

- një raport i pakualifikuar nga audituesit e jashtëm mbi llogaritë, i jep llogarive më shumë besueshmëri, duke rritur interesin e investitoreve në kompani. (1 pikë)

- mungesa e pavarësisë mund të nënkuptojë që nuk është bërë një auditim efektiv. Kështu aksionarët nuk po marrin vlerë nga kostot e ndodhura të auditimit. (1 pikë)

- mungesa e pavarësisë mund të çojë në dështim për te përmbushur kërkesat profesionale të profesionit. Dështimi për ta bërë këtë ul besueshmërinë e profesionit të audituesit dhe standardin që ai zbaton. (1 pikë)

3. Cilët faktorë mund të rrisin kostot e agjencisë të shkaktuara nga një aksioner në një njësi me interes publik?

**Përgjigje:**

**- Shqetësimet mbi strategjitë dhe rreziqet**

Nëse aksioneri shqetësohet për strategjitë që përshtaten ose nivelin e rreziqeve të ndërmarra, ose shumë të larta ose të ulëta nga njësitë me interes publik, ka të ngjarë që kjo të rrit koston e agjencisë (kosto e ndërhyrjes në çështjet e shoqërisë). Në mënyrë të arsyeshme, nëse mbajtësi i aksioneve është i pakënaqur, ai mund të shesë aksionet e tij dhe të investojë në kompani, strategjive të të cilave u beson dhe orekseve të rrezikut të të cilave i ndan. Megjithatë kostot e transaksioneve plus rreziku i mosrealizimit të vlerës së plotë të mundshme nga një shitje mund të nënkuptojë që mbajtësi i aksioneve të hezitojë të shesë aksionet e veta. (1 pikë)

#### **- Mungesa e komunikimit nga kompania**

Nëse kompania nuk ka ose nuk dëshiron të komunikojë në mënyrë aktive atë që aksionarët duhet të dinë, aksionarët do të duhet të gjejnë mjete të tjera për të marrë informacion ose të bëjnë përpjekje për të shprehur pakënaqësinë e tyre. Nga ana tjetër, drejtuesit mund të kërkojnë rritjen e shperblimit për të patur një komunikim me të mirë, duke rritur kështu koston e agjencise. (1 pikë)

#### **- Papërshtatshmëria e qeverisjes së korporatës**

Aksioneri mund të duhet të shpenzojë më shumë përpjekje për të monitoruar atë që po bën kompania nëse kupton se qeverisja e saj është e papërshtatshme. Shqetësimi i veçantë mund të jetë një shef ekzekutiv shumë i fuqishëm dhe mungesa e një pranije të fortë të drejtorit jo-ekzekutiv në bord. Shtesa e drejtuesve jo-ekzekutiv do të rrit koston e agjencise. (1 pikë)

#### **- Konfliktet me aksionarët e tjerë**

Aksionarit mund të pësojë kosto dhe kohë nëse aksionarë të tjerë, më të fuqishëm nuk ndajnë shqetësimin e aksionerit për kompaninë në të cilën kanë investuar. Një kritikë e zakonshme në vitet e fundit është se aksionarët institucionalë u kanë dhënë bordeve shumë lehtësi dhe nuk kanë përdorur fuqinë që u japin aksionet e tyre të mëdha për të shqyrtuar shqetësimet e aksionerëve të vegjël pa shumë ndikim. (1 pikë)

4. Përmendni dhe shtjelloni se cilat janë qëllimet e kodit të etikës së një shoqërie.

Përgjigje:

Qëllimet e kodit të etikës janë:

#### **- Vendosja e vlerave të organizatës**

Kodet etike formojnë pjesë të mjedisit themelor të organizatës. Kodet zhvillojnë dhe promovojnë vlera që lidhen me deklaratën e misionit të organizatës. (0.8 pike)

#### **- Promovimi i përgjegjësisë të palëve të interesuara**

Kodet demonstrojnë gjithashtu se kë konsideron organizata si palë të rëndësishme të interesi si dhe çfarë veprimesh duhet të ndërmerren për të mbajtur marrëdhënie të mira me palët e interesuara. Kodet mund t'u tregojnë paleve të jashtme se kanë të bëjnë me njerëz që bëjnë biznes në mënyrë të drejtë. (0.8 pikë)

#### **- Kontrolli i sjelljes së individit**

Duke promovuar ose ndaluar veprime të caktuara, kodet etike bëjnë pjesë në mekanizmat e burimeve njerëzore me të cilat kontrollohet sjellja e punonjësve. I gjithë personeli duhet të jetë i vetëdijshëm për rëndësinë e kodit etik dhe duhet t'i referohet kur vihen në dyshim veprimet e punonjësve. (0.8 pikë)

#### **- Promovimi i objektivave të biznesit**

Kodet mund të jenë një element i rëndësishëm në pozicionimin strategjik të një kompanie. Marrja e një qëndrimi të fortë ndaj përgjegjësisë dhe etikës dhe fitimi i një reputacioni të mirë etik mund të përmirësojë tërheqjen e konsumatorëve në të njëjtën mënyrë si prodhimi i produkteve me cilësi të mirë. (0.8 pikë)

#### **- Përcjellja e vlerave tek palët e interesit**

Kodi është një pajisje komunikimi, jo vetëm që vepron për të komunikuar midis drejtuesve dhe stafit, por gjithashtu rrit transparencën e marrëdhënieve të organizatës me palët e saj të interesit. (0.8 pikë)

5. Le të supozojmë se jeni duke bërë një kërkim të minutës së fundit për një projekt pune. Meqënëse jeni me nxitim vendosni që ti kopjoni disa prej burimeve nga një listë referencash që gjetët në një artikull mbi temën tuaj, duke dashur që të shtoni numrin e artikujve shkencorë të cituar. A është etike që ju të citoni burime të cilat nuk i keni lexuar?

Përgjigje:

Shpesh thuhet që veprimet jo etike janë dhe joligjore, në këtë rast veprimi është jo etik dhe joligjor. Kemi përvetësim të punës së dikujt tjetër “vjedhje të idesë”. Fakti që ne e kemi me nxitim të kryejmë një punë apo projekt nuk e justifikon “vjedhjen e idesë” së dikujt tjetër.

6. Përmendni disa nga format në të cilat mund të identifikohet fenomeni i korrupsionit, dhe tregoni disa rekomandime për parandalimin dhe zvogëlimin e fenomenit të korrupsionit për punonjësit e sektorit publik dhe privat?

Përgjigje:

Disa nga format në të cilat mund të identifikohet fenomeni i korrupsionit:

- Zyrtarët përfitojnë nëpërmjet abuzimit me të ardhurat shtetërore apo nëpërmjet krijimit të lehtësirave për korruptuesit ... marrja e rryshfetit ... ky fenomen mund të sjellë shmangien nga pagimi i detyrimeve të tatimeve dhe taksave, përfitime të padrejta të subvencioneve të ndryshme, të pensioneve apo pagesave për papunësi, etj ... apo marrja e përfitimeve të pamërituara ose të privilegjeve të tjera për një grup të caktuar njerëzish, të cilat nuk janë të bazuara në ligje apo akte të tjera rregullatore, si psh strehimi, kreditimi, pronësia, etj ...

- Korruptimi i organeve të administratës tatimore ... rryshfeti për zyrtarët e administratës tatimore ... mbulimi abuziv i detyrimeve ... krijimi i marrëvshjeve të fshehta ku punonjësit e administratës tatimore mund të kerkojnë të kenë pjesë apo aksione në shoqëri biznesi të caktuara ...

- Përshpejtimi i kohës së kryerjes së shërbimeve ... rryshfeti për zyrtarin publik apo nëpunës tjetër për dhenie të lejeve, lëshim dokumentash apo dhënie licensash të ndryshme në afate kohore më të shkurtëra se ato që parashikohen nga legjislacioni apo aktet e tjera rregullatore ...

- Influencimi dhe ndikimi në ndryshimin e akteve rregullatore dhe ligjore ... korruptimi i zyrtarëve të nivelit të lartë, sidomos të zyrtarëve qeveritarë që kanë ndikim në proceset e vendimmarrjes ...

Disa rekomandime për parandalimin & zvogëlimin e fenomenit të korrupsionit për punonjësit e sektorit publik dhe privat:

- Ngritja e gjykatave speciale antikorrupsion për të siguruar gjykime me kompetencë dhe procese të shpejta ...

- Përmirësimi i mjedisit juridik dhe rregullator dhe vlerësimi i paanshëm i pasurive të nëpunësve civilë ...

- Inkurajimi i organizatave të biznesit privat & publik për të adoptuar kodet e sjelljes dhe të etikës duke vendosur në nivelin që duhet, parimet bazë të mirëqeverisjes të cilat do të ndikojnë për parandalimin e aktiviteteve korruptive ...

- Inkurajimi i zbatimit të sistemeve komplekse të kontrollit të brendshëm, që do të vepronin si masa parandaluese dhe barriera ndaj aktiviteteve korruptive, më shumë sesa thjesht goditja e keqbërësve të izoluar ...

- Zvogëlimi i pikave të kontaktit me publik të nëpunësve të departamenteve qeveritare, duke bërë të mundur realizimin e këtij kontakti vetëm nëpërmjet zyrave të specializuara, që mund të krijohen pranë tyre ose përmes komunikimeve online, zyra që nga njëra anë do të ndihmonin në grumbullimin e të gjitha shqetësimeve të publikut dhe për dhënien e përgjigjeve në kohë dhe nga ana tjetër do të shërbenin si një trysni ndaj zyrtarëve për të konsideruar si përgjigjet ashtu dhe për të respektuar afatet e caktuara ...

- Përmirësimi i kërkesave të performancës në shërbimin civil (rekrutimi transparent i zyrtarëve', pagesa sipas niveleve të tregut, lidhja e promovimit në detyrë me performancën, e fokusuar kjo në objektiva të qarta dhe përdorimi i standardeve të llogaridhënies dhe transparencës ...

- Përshpejtimi i procesit të privatizimit, përgjithësisht në sektorin strategjik, ku 'ushqimi' për korrupsionin është i madh ...

7. Për të përcaktuar natyrën etike të reklamës, argumentoni se çfarë efektesh duhen mbajtur parasysh?



Përgjigje:

Duhet mbajtur parasysh:

- Efektet sociale, dmth.

Cili është efekti që reklamuesi parashikon të marrë nga reklama?

Cilat janë efektet aktuale të reklamës mbi individët dhe mbi shoqërinë në përgjithësi? ...

- Efektet mbi dëshirat, dmth.

Cfarë bën reklama, informon apo thjesht përpiqet të bindë?

A synon ajo të bindë apo bën një përpjekje për të krijuar një dëshirë iracionale apo një dëshirë që mund të dëmtojë? ...

- Efektet në besime, dmth.

A është përmbajtja e reklamës e vërtetë?

A ka reklama tendencën të c'orientojë audiencën tek e cila drejtohet? ...

## 8. Cilat janë dallimet ndërmjet menaxhimit dhe qeverisjes?

Përgjigje:

Qeverisja e korporatës përfshin “një tërësi marrëdhëniesh ndërmjet menaxhimit të kompanisë, bordit të saj, aksionerëve si edhe të pretendentëve të tjerë” dhe ajo “ofron strukturën nëpërmjet së cilës përcaktohen objektivat e kompanisë si edhe mjetet për arritjen e këtyre objektiveve dhe për monitorimin e performancës. Qeverisja e korporatave përfshin një seri mekanizmesh që rregullojnë raportin e marrëdhënieve të pronësisë me menaxhimin, që ndahen në mekanizma të jashtëm dhe ato të brendshëm. Ajo lidhet me orientimin dhe monitorimin e planifikimit strategjik të organizatës, si edhe vendosjen e kufizimeve dhe kornizave të llogaridhënies.

"Menaxhimi" lidhet me planifikimin, organizimin, drejtimin e shpërndarjes së burimeve si e dhe mbikëqyrja e operacioneve të përditshme të organizatës. Ai i referohet vendimeve rutinë dhe punës administrative në lidhje me operacionet e përditshme të organizatës. Vendimet e menaxhimit duhet të mbështesin ose të zbatojnë qëllimet dhe vlerat e përcaktuara nga organet drejtuese të qeverisjes (si Bordi i Drejtorëve) dhe dokumentet (siç janë politikat dhe procedurat e aprovuara nga bordi).

## 9. Analizo modelet e bordeve.

Përgjigje:

Zakonisht struktura me një apo dy nivele i adresohet modelit të zgjedhur për qeverisjen e korporatave. Në thelb, struktura unitare dhe me dy nivele, në analizë të fundit është e reflektuar tek bordi i drejtorëve dhe mënyra sesi ai konceptohet dhe kompozohet. Në këtë këndvështrim mund të themi se bordet ndahen në dy kategori apo modele: bordi unitar dhe borde me dy nivele. Bordi me një nivel është forma më e përhapur, sidomos në vendet ku predominon modeli anglo-sakson i qeverisjes së korporatave. Bordi me një nivel përfshin brenda vetes drejtorët ekzekutivë dhe ata jo-ekzekutivë, si edhe tenton të marrë vendimet si një grup i vetëm.

Ndërsa bordet me dy nivele kanë dy borde të ndara: një bord manaxhimi dhe një bord tjetër mbikëqyrës. Bordi i manaxhimit zakonisht përfshin vetëm drejtorët ekzekutivë, përqendrohet në çështjet kryesore operationale dhe kryesohet nga shefi ekzekutiv. Ndërsa bordi mbikëqyrës merret vendimet strategjike si edhe mbikëqyr bordin e manaxhimit. Bordi ekzekutiv përbëhet në mënyrë ekskluzive nga drejtorë jo-ekzekutivë.

Bordi mbikëqyrës zakonisht përdoret si një mjet për të sjellë në grupet e ndryshme të stakeholders-ve qeverisjen e korporatës me anën e përfaqësuesve të tyre në bord, sikurse janë punonjësit, e që tipikisht shprehet në atë që në literaturë quhet co-determinimi. Ky është edhe një avantazh i bordeve me dy nivele, por theksojmë, gjithashtu, se efektiviteti i këtij bordi varet, ndër të tjera, edhe nga marrëdhëniet ndërmjet shefit ekzekutiv (CEO) dhe kryetarit të bordit mbikëqyrës. Nëse marrim si shembull shoqëritë aksionere shqiptare të sektorit publik, të rëndësishme në këtë kontekst do të ishin marrëdhëniet ndërmjet drejtorit të kompanisë dhe kryetarit të këshillit mbikëqyrës.

## 10. Dallimet dhe vështirësitë e qeverisjes së korporatave në vendet në tranzicion.

### Përgjigje:

Rregullat e mirë-qeverisjes së korporatave janë zhvilluar nga praktika të korporatave në vëndet e zhvilluara. Kjo e bën të vështirë aplikimin e të njëjtave rregullave në vëndet në tranzicion, për shkak të mjedisit të ndryshëm ku korporatat zhvillohen dhe kryejnë aktivitetin e tyre. Këto ndryshime kontekstuale përbëjnë edhe çelësin për të kuptuar dhe shmangur problemet që dalin në qeverisjen e vëndëve në tranzicion.

- struktura e pronësisë. Në vëndet e zhvilluara, mund të shikohet ndarja e pronësisë nga kontrolli për shkak të dispersionit të pronësisë. Në vëndet në zhvillim, korporatat janë krijuar për shkak të privatizimit masiv, duke krijuar një përqendrim të pronësisë në duart e disa menaxherëve apo aksionerëve individual. Kjo strukturë kompanie nuk lehtëson hyrjen e kapitalit në kompani dhe krijon probleme për aksionerët e minorancës.

- modelet e qeverisjes. Modelet e qeverisjes të vëndëve në zhvillim, preferojnë bordet me dy nivele, duke zgjedhur kështu modelin gjerman. Kjo edhe për shkak të përqendrimit të pronësisë, duke krijuar borde mbikëqyrëse me përfaqësues nga punonjës apo minorancat.

- mungesa e bursës. Mungesa e bursës në vëndet në tranzicion, shkakton probleme në lidhje me raportimin, transparencën si edhe besueshmërinë e kompanive. Kjo ka sjelle një lëvizje të

vogël të kapitalit, duke rritur pronësinë familjare dhe si rrjedhojë duke krijuar struktura pronësie gjithmonë e më të përqëndruara.

- mungesa e kodeve të qarta të qeverisjes Në vendet në zhvillim, në përgjithësi, praktikat e mirë-qeverisjes nuk rregullohen me ligj dhe nuk ekzistojnë kode “të buta”, që mund të identifikojnë karakteristikat e mira të mekanizmave dhe rregullave që korporatat mund të ndjekin për të përmirësuar nivelin e tyre të qeverisjes.

## **USHTRIME (5 pikë secili ushtrim)**

### **Ushtrimi 1**

Ju jeni drejtuesi i skuadrës që po kryen shërbimin e kujdesit të duhur (due diligence) te shoqëria A. Kompania B, klient i juaj, po mendon ta blejë shoqërinë A. Zëvendësuesi juaj ju ka rrëfyer se gjatë punës së tij në skuadrën tuaj ka takuar vajzën e administratorit të shoqërisë A dhe mendon për ta ftuar për të dal për ta njohur më shumë.

**Komentoni mbi çështjet etike dhe çështjet e tjera profesionale mbi situatat më sipër, nëse ka. Në përgjigje duhet të përfshihet kërcënimin që ekziston, rëndësinë e kërcënimit, cdo faktor që ju keni marrë në konsideratë për analizim si dhe nëse është e përshtatshme, çfarë masa mbrojtëse mund të ndërmerrni për të eliminuar ose ulur kërcënimin.**

Përgjigje:

Dy çështje ngrihen:

- E para është se kompanisë B me sa duket jemi duke i ofruar dy shërbime, që mund të çojë në kërcënimin e vetë rishikimit. Për sa i përket kësaj çështje, nuk ka informacion të mjaftueshëm për të nxjerrë konkluzion në lidhje me rëndësinë e këtij kërcënimi. Faktorët relevant do të ishin çështje të tilla si natyra e shërbimeve, tarifa totale dhe anëtarët e skuadrës të alokuar në secilin shërbim. Për sa i përket masave mbrojtëse, mund të ishte përfshirja e stafit të ndryshëm në secilin shërbim. Rreziku ka të ngjarë të jetë i lartë vetëm nëse një nga shërbimet e ofruara është auditimi, i cili nuk është treguar në pyetje. (2.5 pikë)

- E dyta është se zëvendësuesi i caktuar për due diligence do të angazhohet në marrëdhënie personale me një person të lidhur me shërbimin, gjë që mund të çojë në kërcënimin e familiaritetit ose frikësimit. Faktorët relevant janë: anëtari i skuadrës ka një rol të rëndësishëm në skuadër, si i dyti në detyrë; pala tjetër (vajza e administratorit të shoqërisë A) është e lidhur ngushtë me stafin e shoqërisë që po rishikohet dhe koha kur ndodh shërbimi. Në këtë situatë, ju jeni duke kryer një rishikim (due diligence) të vetëm të shoqërisë dhe koha e kryerjes së shërbimit është një element kryesor. Aktualisht zëvendësuesi juaj nuk ka një marrëdhënie personale e cila do të kërcënonte në mënyrë të konsiderueshme pavarësinë e angazhimit. Në këtë situatë masë mbrojtëse do të ishte ti kërkohej zëvendësuesit të mos marrë asnjë veprim derisa angazhimi të përfundojë. Nëse ai refuzon, atëherë mund të konsiderohet të kërkohej rotacioni i stafit dhe zëvendësuesi të largohej nga skuadra. (2.5 pikë)

## **Ushtrimi 2**

Organizata profesionale njoftoi partnerin e një firme auditimi, e cila ka zyra auditimi në disa qytete, se duhet të tërhiqet nga auditimi pasi ishin në shkelje të parimit të pavarësisë, pasi kunati i partnerit të firmës është drejtues financiar i klientit të auditimit. Gjithashtu autoriteti rregullator kërkoi që duhet të zhvendosin zyrën e punës të paktën 500 km larg nga vendndodhja e klientit, duke e bërë në këtë mënyrë, punën të paarritshme. Firma e auditimit e pa këtë veprim të organizatës profesionale si absurd. Shumë shpejt, pas kësaj ndodhie, firma e auditimit propozoi të ndahej në tre firma me aktivitetet të ndryshme: auditim, taksa dhe konsulencë financiare.

**Diskutoni impaktin që ngjarjet e mësipërme mund të kenë në perceptimin publik në lidhje me integritetin, objektivitetin dhe pavarësinë e firmës së auditimit.**

Përgjigje:

### **Objektivitetit**

Marrëdhënia familjare midis audituesit dhe klientit mund të prek objektivitetin e auditimit, prandaj audituesit këshillohen që të mos ndërtojnë marrëdhënie personale me klientët e auditimit dhe të mos auditojnë kompani ku familjarët e tyre janë punësuar në pozicione që prekin llogaritë. Në rastin në fjalë, nëse partneri i firmës së auditimit i cili ka marrëdhënie familjare, nuk është partneri i angazhimit, firma duket se është e pavarur pasi partneri që ka lidhje familjare nuk ka lidhje me auditimin, përveçse nëse partneri i angazhimit është partneri që ka lidhje familjare. (1.67 pikë)

### **Kërkesa e organizatës profesionale**

Është e rëndësishme që audituesit të jenë, dhe të duket se janë të pavarur. Marrë parasysh kushtet e sotme, vendndodhja fizike nuk e pengon audituesin për tu angazhuar me një klient. Sidoqoftë organizata profesionale duket se është e shqetësuar për pavarësinë në dukje, pasi publiku mund të mos e kuptojë dallimin midis një partneri dhe një partneri angazhimi. Nga ana tjetër, marrë parasysh kushtet e sotme të komunikimit, edhe publiku mund të mos bindet se largimi i një anëtarë në një qytet tjetër do të zgjidh çështjen e pavarësisë. (1.67 pikë)

### **Ndarja e aktiviteteve në firma të ndryshme**

Vendimi për të ndarë aktivitetet në tre firma të ndryshme mund të rrit perceptimin e publikut për pavarësinë e aktivitetit të auditimit. Mund të ketë skepticizëm për sa i përket arsyeve të ndarjes, por gjithsesi përfitimet e objektivitetit ruhen në këtë formë. (1.67 pikë)

## **Ushtrimi 3**

Një klient i juaji, pjesë e një grupi, prodhon dhe shet një gamë të gjerë produktesh, përfshirë veshje, pajisje audio etj. Ngjarja më poshtë ka ndodhur gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2020, auditimi i cili është duke përfunduar:

Gjatë numërimit vjetor të inventarit në magazinës e kompanisë që tregton veshje mode, stafit të auditimit që mori pjesë në numërimin e inventarit ju ofrua të blinte çfarëdo veshje në 30% të cmimit të rekomanduar për shitje te konsumatori përfundimtar.

**Diskutoni çështjet etike të ngritura dhe veprimet që duhen ndërmarrë audituesi në lidhje me situatën më sipër.**

Përgjigje:

### **Çështjet etike**

Kodi i etikës pohon se duhet të pranohet vetëm dhurata dhe mikëpritje në kushte normale të biznesit ose dhurata dhe mikëpritje të parëndësishme. Marrë parasysh çmimin e ofruar të veshjeve, duke qenë se nuk është në kushtet normale të biznesit, kjo mund të çojë në kërcënim kundrejt respektimit të parimeve themelore. Termi “të parëndësishme” duhet të konsiderohet në termat e materialitetit për audituesin dhe klientin. Oferta nuk është materiale për klientin, pasi veshjet janë vetëm një pjesë e 7 produkteve të grupit. Sidoqoftë, oferta e blerjes në 30% të çmimit të rekomanduar të shitjes te konsumatori përfundimtar për çfarëdo veshje është shumë materiale për anëtarët e skuadrës së auditimit. Në këtë kontekst, dhurata nuk është dhe aq e parëndësishme. Përveç kësaj, pranimi i ofertës gjatë numërimit të inventarit mund të sjellë diferenca gjatë numërimit, gjë që mund të kompromentojë saktësinë e numërimit të inventarit. Nëse kjo ndodh, audituesit mund të penalizohen për neglizhencë pasi stafi nuk e ka bërë punën siç duhet. (3 pikë)

### **Veprimet që duhen ndërmarrë**

Skuadra e auditimit nuk duhet ta pranojë ofertën në numërimin e inventarit. Partneri i angazhimit duhet ta diskutojë çështjen me drejtimin, për të saktësuar nëse është e duhur që stafi i tyre ta marrë dhuratën, pasi përveç sa më sipër kjo mund të çojë që klienti i auditimit të shihet si një punë shpërblyese nga skuadra e auditimit. Në mënyrë alternative, mund të jetë e duhur që firma e auditimit të vendosë një limit monetar që skuadra mund të pranojë. (2 pikë)

## **Ushtrimi 4**

Çfarë këshille do të jepnit në rastin e kësaj dileme etike? Bela është punësuar si redaktore e përkohshme e broshurës informative të kompanisë. Ajo merr një artikull të shkruar nga presidenti i kompanisë i cili përshkruan me një gjuhë abstrakte dhe pompoze objektivat e kompanisë për vitin e ardhshëm. Bela mendon që artikulli duhet të rishikohet, për të qenë i lexueshëm. Ndërkohë bashkëlidhur me artikullin janë dërguar dhe dy komente përgëzuese nga ana e dy zëvendës presidentëve të kompanisë.

**Si mund të veprojë Bela në këtë rast?**

Përgjigje:

Objektivat në kompanitë e biznesit duhet të jenë reale dhe të arritshme, në rastin në fjalë redaktorja e përkohshme e broshurës informative duke qenë dhe eksperte e fushës ka të drejtë të shpreh mendimin e saj presidentit të kompanisë. Ajo duhet të bëjë të qarta rreziqet që mund të vijnë biznesit nga publikimi i një broshure të tillë dhe ky komunikim është absolutisht i nevojshëm dhe nuk përbën shkelje të rregullave etike. Përkundrazi ndihmon që kompania të mos shpërndajë informacione jo korrekte.

## **Ushtrimi 5**

Pas një diskutimi të zgjatur madje edhe një konflikti për zgjedhjen e planit A ose B, ekipi që është ngritur në punën tuaj përfundimisht ka rënë dakort për planin B, por ju vetë jeni të bindur plotësisht se plani A është një zgjedhje shumë herë më e mirë. Ekipi juaj është duke ia prezantuar planin B të gjithë departamentit në një mbledhje në të cilën janë të pranishëm edhe drejtuesit e kompanisë. Një nga nëndrejtorët ju pyet për opinionin tuaj. Ju :

- a. Do ta kaloni në heshtje?
- b. Do përpiqeshit ti bindnit ta pranoni planin A?
- c. Do shpjegoni arsyet se pse plani A është më i mirë?
- d. Do ti tregonit nëndrejtorit dhe të gjithë të pranishmëve se plani B nuk ka qënë ideja juaj?
- e. Do të diskutoni mbi një nga dy pikat e planit B që edhe për ju kanë qënë të pranueshme?

**Argumentoni zgjedhjen tuaj në analizimin e kësaj çështje etike.**

**Përgjigje:**

Referuar çështjes etike të rastit 5, alternativa e duhur do të ishte d, në këtë rast personave të pranishëm duhet ti bëhet me dije se plani B nuk ishte ideja juaj. Ne duhet të mbrojmë idetë dhe planet që propozojmë pavarësisht mendimit të shumicës së grupit. Në këtë rast ne mund të bëjmë një krahasim të të dy planeve dhe avantazheve që ka secili në organizatën e biznesit.

## **Ushtrimi 6**

Kompanitë e ristrukturimit të kredive (që ofrojnë kredi të reja ndaj kredimarrësve me problem në shlyerjen e kredive ekzistuese), janë të famshme për bërjen e premtimeve të mëdha të cilat nuk janë në gjendje ti përmbushin ligjërisht më pas. Komisioni Federal i Tregtisë së SHBA-ve ka paralajmëruar se asnjë prej këtyre kompanive nuk është e ligjshme. Ekspertët thonë që njerëzit që kanë probleme me historinë e tyre të kreditimit do të ishin më të fituar, nëse do ti kursenin paratë e tyre dhe do të përpiqeshin “ti rregullonin” vetë kreditë e tyre të këqija. Një prej mënyrave për të përmirësuar imazhin e “kredimarrësit të keq” është të shkruani një letër që shpreh vullnetin e mirë. Sa më sipër një letër e tillë është ajo që u drejtohet kreditorëve individual me lutjen për të ndaluar raportimin e informacioneve negative, si psh. vonesat në pagesa që mund të ndodhin ndaj secilit kreditor dhe evidentimin e tyre në kartën e kreditit.

**Diskutoni se përse shkrimi i këtyre letrave është një strategji më e mirë sesa një email ose telefonatë.**

**Përgjigje:**

Për shumë kompani dhe institucione publike email është një mjet zyrtar komunikimi por në rastin në fjalë opsioni më i mirë do të ishte dergimi i një letre. Marrja e një letre shpesh herë i bën individët të ndjehen më të vlersuar dhe ta marrin më seriozisht situatën. Duke qënë se target grupi që i drejtohet letra janë kreditorë individual letra gjithashtu duhet të jetë e qartë dhe të ketë një mesazh direkt.

### **Ushtrimi 7**

Mira dhe Entela, te dyja punonjëse në një kompani pijesh freskuese po diskutonin me njëra-tjetrën lidhur me etikën e biznesit. Konkretisht, Mira thoshte që mjafton etika personale dhe parimet e shëndosha morale të individit për të trajtuar çështjet etike që mund të lindin në një organizatë biznesi, kurse Entela thoshte që kjo gjë nuk mjafton, por duhet më tepër.

**Cilën mbështetni nga punonjëset, Mirën apo Entelën? Nëse mbështesni Mirën, zgjerojeni përgjigjen; nëse mbështesni Entelën, argumentoni pse nuk mjafton dhe çfarë duhet më shumë?**

Përgjigje:

Mbështetja në këtë rast është për Entelën, pra që nuk mjafton etika personale dhe parimet e shëndosha morale të individit për të trajtuar çështjet etike që mund të lindin në një organizatë biznesi. Është e rëndësishme që të njihet raporti midis vendimeve ligjore dhe atyre etike. Një nivel i lartë i cilësive morale individuale nuk mjafton që një individ të mos shkelë ligjin në një kontekst organizativ të komplikuar. Ndodh shpesh që edhe profesionistë me shumë eksperiencë në fushën e jurisprudencës të debatojnë lidhur me mënyrën se si duhet të interpretohet ligji. Pra, vlerat që ne kemi mësuar nga familja, besimi fetar apo shkolla mund të mos na japin udhëzimet e nevojshme për të vlerësuar këto vendime komplekse të biznesit. Eksperiencat e biznesit janë të ndryshme dhe vlerësimi i vendimmarrjeve të tij ka në sfond një eksperiencë shumëvjeçare të akumuluar, e cila është tepër e nevojshme për të përcaktuar se çfarë është e pranueshme dhe çfarë është etike. Sugjerohet që organizatat të bëjnë trajnime për punonjësit në fushën e etikës, si dhe atë ligjore.

### **Ushtrimi 8**

A ka lidhje diversiteti gjinor me performancën e bordit?

Përgjigje:

Një nga karakteristikat e rëndësishme të përbërjes së bordit të drejtorëve lidhet me diversitetin gjinor. Lidhja e pranishme femërore me performancën e bordit ka patur shumë interes nga studiues të ndryshëm të qeverisjes së korporatave. Gjithësesi, ekzistojnë edhe shumë rezultate kundërshtuese në literaturë.

Nga njëra anë, një pjesë e studimeve evidenton faktin se rritja e pranishme femërore në borde sjell një numër përfitimesh direkte për korporatat, duke përfshirë praktikatat e përmirësuara të

qeverisjes, një performance më të mire ekonomike/financiare, inovacion, interes më të lartë mbi përgjegjësinë sociale dhe ambientale, një reputacion më të mire në treg, si edhe rritje të vlerës së aksioneve. Gjithashtu, disa studime psikologjike theksojnë faktin se prania femërore duhet të përmirësojë nivelin e vendim-marrjes në grup, të uli tensionet dhe të rrisi përgjegjësinë e vendimeve, duke rritur ethos-in kolektiv dhe nivelin e vlerave që grupi adapton.

Nga ana tjetër, një seri evidencash empirike tregojnë se shpeshherë faktori 'rozë' nuk varet nga diversiteti gjinor, por nga mënyra e përfaqësjes që individët kanë në bord. Pra, faktorë si eksperiencia, formimi apo natyra personale, kanë një impact më të rëndësishëm se prania e diversitetit gjinor.

Gjithësesi, pranohet gjërësisht që prania femërore duhet të rritet jo vetëm për të dhënë oportunitete të barabarta, por edhe për të përmirësuar, sic evidentohet në disa raste, efektivitetin e qeverisjes së korporatave.

## **Ushtrimi 9**

Vlerësoni fushat kryesore të konfliktit potencial të interesit midis aksionerëve (shareholders) dhe drejtuesve ekzekutiv dhe shpjegoni se si drejtuesit jo-ekzekutiv mund të ndihmojnë në zgjidhjen e këtij konflikti.

**Përgjigje:**

Një konflikt interesi potencial mund të lind kur drejtuesit ekzekutiv marrin vendime që nuk janë në interes të aksionerëve të shoqërisë. Fushat më kryesore që mund të lindin konfliktet e interesit janë:

- Shpërblimi

Nëse drejtuesit ekzekutiv e vendosin vet shpërblimin e tyre, krijohet hapësirë abuzimi. Gjithshtu nese ata vendosin skema bonusi per veten e vet, performanca e synuar e ketyre skemave jo domosdoshmerisht do te jete e njejte me interesat e aksionereve. Per kete konflikt, shume korporata formojne komitetin e shperblimit, i cili vendos per shperblimet dhe bonuset e drejtuesve ekzekutiv. Anetaret e ketij komiteti duhet te jene te gjithte te pavarur dhe jo pjese e ekzekutivit. Komiteti mund gjithashtu te rekomandoje dhe monitoroje nivelin dhe strukturen e shperblimit per drejtuesit e larte, duke lidhur objektivat e drejtuesve ekzekutiv me ato te aksionareve. (2 pike)

- Raportimi financiar

Drejtuesit ekzekutiv mund te tundohen per te modifikuar rezultatin financiar te shoqerise, ne menyre qe ta paraqesin ate ne nje menyre qe te duken me mire dhe se kane arritur objektivat ne menyren e duhur. Per kete konflikt, mund te formohet komiteti i auditimit, i perbere nga drejtues jo-ekzekutiv, detyra e te 8 cileve do te jete te konsiderojne ceshtjet e raportimit financiar dhe sistemeve te kontrollit financiar. (2 pike)

- Emërimi në komitete



Nje drejtues ekzekutiv mund te tundohet te emeroje suportuesit e vet ne komitete, per te forcuar pozicionin e tyre. Per te zgjidhur kete konflikt, mund te formohet komiteti i emerimeve i perbere nga drejtues jo-ekzekutiv. Ky komitet mund te drejtoje rekrutimin per te mbajtur nje balance ne komitete. (1 pike)

## **Ushtrimi 10**

Argumentoni arsyet se pse kompanitë dëshirojnë të shpalosin informacionin mjedisor në pasqyrat e tyre financiare. Argumentoni nëse përmbajtja e kësaj shpalosje duhet të jetë në zgjedhjen e kompanive.

### **Përgjigje:**

Kryesisht arsyet se pse kompanite deshirojne te shpalosin informacionin mjedisor ne pasqyrat financiare ka te beje me impaktin qe lene te palet e interesuara.

#### **Interesi i palëve të interesuara**

Interesi i publikut per pergjgshmerine sociale te korporatave vjen duke u rritur. Palet e interesuara pershine klientet, punonjesit, publiku ne teresi dhe te gjitha ta qe jane te interesuar ne impaktin e operacioneve te korporates ne mjedis dhe komunitet. Keto pale mund te kene nje efekt te konsiderueshme ne performancen e kompanise. Si rezultat kompanite, per te rritur reputacionin e tyre social dhe mjediso publikojne informacion mjedisor ne pasqyrat financiare. (1.25 pike)

#### **Interesi i rregullatoreve dhe profesionistëve**

Nje faktor tjetër është rritja e interesit nga organet qeveritare dhe profesionale. Edhe pse nuk ka standarde qe te kerkojne ne menyre specifike raportimin mjedisor, kjo mund te kerkohet nga legjislacioni qe prekin shoqerite. (1.25 pike)

#### **Impakti në performancë**

Praktikat e pergjegjesise ne fusha te tilla si ulja e demtimit te mjedisit mund te rrit vleren e kompanise. Kompanite qe veprojne ne menyre te pergjegjshme me mjedisin dhe bejne shpalosje per kete, perceptohen si nje investim me i mire se sa ato qe nuk e bejne. (1.25 pike)

#### **Shpalosje e detyrueshme apo vullnetare**

Aktualisht, kompanite mund te mos shpalosin informacion per mjedisin nese nuk deshirojne (pervec atyre te kerkuara me ligj). Kjo mund te coje ne nje numer problemesh. Shpalosja e informacionit do te jete selektive dhe e veshtire per tu krahasuar me shoqerite e tjera. Sidoqofte, kompanive duhet tu lihet nje hapersire per te percaktuar informacionin qe do te shpalosin, ne menyre qe shpalosja e detyrueshme te mos behet si nje liste per tu plotesuar duke dhen informacion te pergjithshem qe do te jete shume pak i dobishem per palet e interesuara. (1.25 pike)